

VENDIM
Nr. 721, datë 12.10.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.185, DATË 2.4.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
REALIZIMIT TË KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT E MOSHËS
40-65 VJEÇ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.185, datë 2.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Titulli i vendimit ndryshon dhe bëhet “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35-70 vjeç”.

2. Pika 2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2. Të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë. Identifikimi i shtetasve të grupmoshës 35-70 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë realizohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të regjistrit elektronik, që administrohet nga mjekët e përgjithshëm të qendrave shëndetësore.”.

3. Pas nënpikës “vi”, të shkronjës “c”, të pikës 3, shtohen nënpikat “vii” dhe “viii”, me këtë përmbajtje:

“vii) urea;

viii) kreatinina.”.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi